



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti Prizren Prizren Üniversitesi "UKSHIN HOTI" F. i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	
Planuar me dt.	30.12.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
507	1-137

FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT

KËSHILLI I FAKULTETIT

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Prizren, më 30.12.2019

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 76 paragrafi 1 alineja 1.9 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" (referuar si Universiteti) sipas referencës nr. 04-V-621 të datës 30 maj 2013, duke vendosur në lidhje me miratimin e Planit strategjik të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (referuar si FSHJM), Këshilli i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Plani strategjik i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në Universitetin "Ukshin Hoti" për periudhën kohore 2020–2024.
- II. Plani strategjik i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në Universitetin "Ukshin Hoti" për periudhën kohore 2020–2024, do të rishikohet çdo vit akademik.
- III. Pjesë përbërës e këtij vendimi është edhe Plani strategjik i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në Universitetin "Ukshin Hoti" për periudhën kohore 2020–2024.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ndërsa Plani strategjik i FSHJM-së fillon të zbatohet nga 1 janari 2020.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh domosdoshmërinë për hartimin e një Plani strategjik të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në Universitetin "Ukshin Hoti" për periudhën kohore 2020–2024, kjo strategji ka për qëllim që të adresojë nevojën, që të precizohen masat dhe instrumentet e FSHJM-së. FSHJM-ja si njësi akademik e Universitetit duhet të ndërmarrë hapa drejt zhvillimit akademik të arsimit të lartë, duke synuar tregun e punës, ndërkombëtarizmin dhe plotësimin e nevojave të shoqërisë në tërësi. FSHJM-ja ka për qëllim që të arrijë të jetë njësi akademike publike hulumtuese edhe më e suksesshme, e njohur për profesionalizëm, integritet, mësimdhënie cilësore dhe hulumtime shkencore të arrira.

Prandaj, mbi këtë bazë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

Këshillit Drejtues
Menaxhmentit
Këshillit të Fakultetit
Të shpallet në ueb¹ dhe
Arkivit

Kryesues i Këshillit të Fakultetit

Prof. asoc. dr. Isuf Lushi



¹ Të Universitetit "Ukshin Hoti"



FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT
Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren
Rr. Shkronjave 1, 20000 Prizren
Republika e Kosovës

FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT

PLANI STRATEGJIK 2020-2024

**FAKULTETI I SHKENCAVE
TË JETËS DHE MJEDISIT**

Plani Strategjik 2020-2024

**Kujdesi ndaj natyrës,
kujdes për veten tonë**

Dhjetor 2019

SHKURTESAT

FSHJM	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit
SHPM	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit
AGB	Agrobiznes
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MSH	Ministria e Shëndetësisë
BE	Bashkimi Evropian
BKI	Bordi Këshillëdhënës Industrial
RVV	Raporti i vetëvlerësimit
AKA	Agjencia Kosovare e Akreditimit
OJQ	Organizatrat joqeveritare
GIS	Sistemi i informimit gjeografik

PËRMBAJTJA

Fjala e dekanit

Historiku i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

1. Themelet e planit strategjik

- 1.1. Misioni
- 1.2. Vizioni
- 1.3. Vlerat
- 1.4. Grupet e interesit

2. Procesi i planifikimit strategjik

- 2.2. Analiza e pozicionimit

3. Prioritetet strategjike

- 3.1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie
- 3.2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore
- 3.3. Kontributi në komunitet
- 3.4. Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit
- 3.5. Zhvillimi i infrastrukturës
- 3.6. Qëndrueshmëria financiare

4. Plani i veprimit

FJALA E DEKANIT

Në cilësinë e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (tutje referuar si FSHJM) të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, në emër të stafit akademik, administrativ dhe studentëve si dhe në emrin tim, ju dëshiroj mirëseardhje.

Stafi akademik i FSHJM-së kujdeset për mësimdhënie cilësore, duke ofruar përvojat e mira të edukimit të bazuar në Kornizën Evropiane të Arsimit. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi i stafit akademik me studentët tanë është shumëdimensional. Studentët përfitojnë nga gërshetimi i njohurive teorike me punën praktike, nëpërmjet vizitave dhe ekspeditave studimore. Vlerë e shtuar e FSHJM është edhe mundësia e punës praktike në laboratorët e mirëpajisur. Aftësimi i mirëfilltë profesional u mundëson studentëve tanë avantazh konkurrues në tregun e punës.

Për më tepër, FSHJM zhvillon një aktivitet të ngjeshur të punës kërkimore-shkencore, së bashku me studentët e vet. FSHJM është krenar që përfaqëson një nga të paktat institucione të arsimit të lartë që zbaton sistemin "Të mësosh duke bërë", nëpërmjet gërshetimit të rasteve studimore me njohuritë teorike.

Përfundimisht, FSHJM i kushton theks të veçantë bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin e biznesit. Ky bashkëpunim shtrihet në lidhjen me industrinë prodhuese, agropërpunuese, menaxhuese dhe tregtare, pyjore dhe mbrojtjes së mjedisit.

Ju mirëpres që të bashkoheni në komunitetin tonë kreativ!

Prof. Asoc. Dr. Isuf Lushi

Dekan i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK

Ky plan strategjik është hartuar në bazë të vendimit të Këshillit të FSHJM-së me Referencë 01-69 të datës 29.08.2019 dhe plotësim-ndryshimit të tij sipas vendimit 01-119 të datës 11.12.2019.

Plani Strategjik 2020-2024 është hartuar pas konsultimeve intensive dhe gjithëpërfshirëse të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të FSHJM-së. Të gjitha aktivitetet zhvillimore të FSHJM-së do të mbështeten dhe do të udhëhiqen nga ky plan strategjik.

Anëtarët e komisionit të hartimit të planit strategjik

Prof. Ass. Dr. Albana Plaqiqi Milaimi, kryetare

Prof. Asoc. Dr. Isuf Lushi, anëtar

Prof. Ass. Dr. Sadik Maloku, anëtar

LL. M. Nexhmedin Krasniqi, anëtar

Z. Shpend Laçaj, anëtar (përfaqësues i studentëve)

Z. Egzon Elshani, anëtar (përfaqësues i Drejtorisë së Bujqësisë,

Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Prizrenit)

Z. Sami Dida, anëtar (përfaqësues i komunitetit të biznesit të Komunës së Prizrenit)

Z. Bexhet Basha, anëtar (Përfaqësues i OJQ "Rimëkëmbja e bujqësisë").

HISTORIKU I FSHJM

FSHJM u themelua në vitin 2016. Në bazë të propozimit të ish-rektorit dhe komisionit profesional për hartimin e programeve studimore, Këshilli Drejtues i Universitetit “Ukshin Hoti” themeloi FSHJM-në.

Bazuar në specifikat e Universitetit “Ukshin Hoti” dhe kërkesat e tregut të punës në regjionin e Prizrenit (dhe Kosovës) programet e reja studimore të prezantuara në këtë strategji kontribuojnë jo vetëm në rritjen e performancës së Universitetit “Ukshin Hoti”, por edhe markimin e Universitetit. Duke marrë për bazë traditën e regjionit të Prizrenit dhe pozitën gjeografike, këto programe do të ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shkencor të këtij regjioni.

Aktualisht, në FSHJM janë të regjistruar 232 studentë; respektivisht 90 studentë në drejtimin Agrobiznes dhe 142 studentë në drejtimin e Shkencave të Pyjeve dhe Mjedisit. Struktura socio-ekonomike e studentëve u përgjigjet studentëve me prejardhje nga viset rurale të Kosovës, kryesisht të rrethit të Prizrenit, por edhe të viseve të tjera të Republikës së Kosovës.

FSHJM organizon programet e studimeve në nivelin baçelor në gjuhën shqipe. Njëkohësisht, brenda një periudhe afatmesme planifikon hapjen e programeve studimore në nivelin master.

Programet aktuale të studimit në nivelin Baçelor janë:

- Agrobiznes, dhe
- Shkencat e pyjeve dhe mjedisit.

Programet e planifikuara të studimit në nivelin Baçelor janë:

- Shkencat e ushqimit dhe nutricioni,
- Arkitekturë e peizazhit dhe
- Një program në gjuhën angleze sipas kërkesave të tregut të punës.

Programet e planifikuara të studimit në nivelin Master:

- Menaxhim agrobiznesi, dhe
- Menaxhimi i integruar i pyjeve dhe mjedisit.

Mësimdhënësit e FSHJM-së, në formë individuale dhe grupe, zhvillojnë hulumtime shkencore nga fushat e tyre të studimit. Rezultatet e këtyre kërkimeve, prezantohen në kongrese, konferenca dhe takime të tjera shkencore në vend dhe jashtë vendit. Në funksion të procesit të ndërkombëtarizimit, planifikohet përfshirja e stafit akademik të huaj në procesin mësimor, në zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore, si dhe në botimet e përbashkëta të punimeve shkencore, monografive, teksteve universitare etj.

FSHJM ka themeluar Bordin Këshillëdhënës Industrial (BKI) në funksion të bashkëpunimit dhe ndërveprimit të fakultetit me komunitetin e biznesit dhe palët e jashtme të interesit. Ky bashkëpunim synon shkëmbimin e përvojave të mira dhe rekomandimeve me dobi reciproke (këshillime, trajnime, studime të përbashkëta, mundësi punësimi, ekspertiza, praktika profesionale etj.).

Objekti i FSHJM-së gjendet brenda kampusit të Universitetit “Ukshin Hoti”. Në infrastrukturën e FSHJM-së synohet të avancohet dhe të krijohet një hapësirë e përshtatshme, në

mbështetje të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Po ashtu, planifikohet modernizimi i infrastrukturës teknologjike (pajisja e laboratorëve me inventarë dhe pajisje laboratorike, pajisja e kabinetit të informatikës), si dhe pasurimi i bibliotekës mbeten si pika prioritare të FSHJM-së.

Planifikimi i punës kërkimore-shkencore

Kërkimet shkencore të stafit akademik janë të fokusuara në:

- Strategjitë dhe politikat e zhvillimit rural të integruar.
- Hulumentimet e rasteve studimore të kompanive të agrobiznesit në rajonin e Prizrenit.
- Kontributi në hartimin e politikave bujqësore kombëtare dhe rajonale.
- Strategjitë e menaxhimit të inputeve dhe outputeve në bujqësi.
- Strategjitë dhe politikat e menaxhimit të agrobiznesit.
- Strategjitë dhe politikat e integritit të fermerëve në tregje vendore dhe ndërkombëtare.
- Probleme të menaxhimit & marketingut në zinxhirin e ofertës dhe krijimin e vlerës së shtuar.
- Strategjitë dhe politikat e zhvillimit të kompanive private në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.
- Strategjitë dhe politikat e zhvillimit të turizmit rural.
- Politikat e menaxhimit të pronave bujqësore, si dhe integrimi dhe kooperimi i tyre.
- Analiza e tregjeve të ushqimit dhe diversifikimit të ushqimit.
- Ofrimi i shërbimeve këshillëdhënëse për fermerët, me theks të veçantë në rajonin e Prizrenit.
- Potenciali i produkteve organike në tregun vendor.

- Studimi i vegjetacionit në vendet e ndotura dhe krahasimi me vendet e kontrollit.
- Studimi i dëmtuesve pyjorë (fitofagëve dhe ksilofagëve) në pyjet e vendit.
- Studimi i sëmundjeve bimore pyjore nga mikroorganizmat.
- Studimi i ndikimit të ndotjes së mjedisit mbi vegjetacionin dhe botën animale në pyje.
- Zhvillimi i sektorit pyjor në fokusin historik.
- Zhvillimi i metodave të inventarizimit dhe monitorimit për bimët aromatike dhe mjekësore.
- Studimi dendroekologjik i llojeve pyjore të rritura në kushte stacionale ekstreme.
- Rritja e kapaciteteve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në fushat e politikës dhe ekonomisë pyjore.
- Struktura mikro dhe makroskopike e drurit, vetitë fizike, mekanike e teknologjike të drurit dhe të materialeve me bazë druri.
- Menaxhimi i qëndrueshëm i Pyjeve dhe resurseve Pyjore
- Aplikimi i metodave silvikulturore në kontekstin e menaxhimit të pyjeve
- Identifikimi i llojeve të drurëve pyjorë që ekzistojnë në vendin tonë, dhe llojeve endemike
- Ekspertiza dendrometrike dhe dendrokronologjike të drurëve pyjorë
- Aplikimi i metodave me të reja të shfrytëzimit të pyjeve
- Aktivitete në kontekstin e Planifikimit pyjorë, Plane Menaxhuese, Inventarizime Nacionale, etj.
- Aktivitete lidhur me Menaxhimin e Zonave të mbrojtura

- Aplikimi i metodave Agropyjore, si aktivitete me trend të lartë ndërkombëtar.
- Trajnimi i punëtorëve për operacionet pyjore.
- Menaxhimi i zonave të mbrojtura pyjore.
- Mbrojtja e personelit pyjorë në shfrytëzimin e pyjeve.
- Turizmi malor dhe ekologjik në Kosovë.
- Mundësitë e ripërtëritjes së pyllit me metoda silvikulturore të qëndrueshme.
- Mundësia e përdorimit të teknologjive të reja në pyje.
- Ndërhyrjet silvikulturore.
- Rivitalizimi i sipërfaqeve të degraduara në pyll.
- Mbrojtja e pyjeve nga zjarret.

1. THEMELET E PLANIT STRATEGJIK

Vendimet strategjike të FSHJM-së mbështeten në trashëgiminë historike, traditën biznesore dhe tregtare të rajonit të Prizrenit si dhe veçoritë e diversitetit kulturor dhe gjuhësor.

- FSHJM është **institucion publik** i identifikuar si njësi akademike në kuadër të Universitetit “Ukshin Hoti”. Ky fakultet është ndërtuar mbi themelet e një makromjedisi me trashëgimi të pasur biznesore, zejtare, shkencore, kulturore dhe historike të rajonit.
- Selia e FSHJM-së gjendet në **qytetin e Prizrenit**. Ky qytet njihet zyrtarisht si kryeqytet historik i Republikës së Kosovës. I njohur ndryshe si selia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe si djep i historisë, kulturës, artit dhe shkencës.

- Komuniteti në të cilin zhvillon aktivitetin e vet FSHJM njihet për **tradiçën në biznes**. Historikisht, ky komunitet ka kontribuar në zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik rajonal, kombëtar dhe më gjerë.
- Makromjedisi në të cilin vepron FSHJM karakterizohet nga një **diversitet gjuhësor, etnik dhe fetar**. Ky diversitet paraqet një vlerë të shtuar për Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit.
- FSHJM aktualisht i ka **2 programe studimore** në nivelin baçelor.
- FSHJM ka **standardizuar infrastrukturën dhe hapësirat për studim** në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve, stafit akademik dhe stafit administrativ.
- FSHJM ka ndërkombëtarizuar aktivitetet e saj nëpërmjet **rrjetëzimit ndërkombëtar** duke nënshkruar një numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve të bashkëpunimit.
- FSHJM ka konsoliduar **bibliotekën e fakultetit dhe bibliotekën elektronike** duke e pasuruar atë me një fond të madh të librave për nevoja të programeve studimore dhe kërkime-shkencore.
- FSHJM ka ndërtuar një **lidhje të ngushtë me komunitetin e biznesit**. Për këtë qëllim ka themeluar Bordin Këshillëdhënës Industrial (BKI).

1.1. Misioni

FSHJM ka për mision edukimin cilësor dhe kërkimin shkencor në fushat e Agrobiznesit dhe Shkencave të Pyjeve dhe Mjedisit, si dhe kontributin e FSHJM në komunitetin lokal, kombëtar dhe më gjerë.

1.2. Vizioni

FSHJM përpiqet të jetë një shembull për të mbështetur studentët, komunitetin dhe gjithçka që lidhet me ta. Në gjithçka që bëjmë, synojmë:

- Të jemi lider në ofrimin e edukimit në nivel kombëtar dhe konkurrues në nivel rajonal, si dhe të kemi bashkëpunim të ngushtë me qendrën e inovacionit dhe punësimit në Prizren.
- Të ofrojmë shërbime të konsulencës për komunitetin (bizneset, OJQ-të, Institucionet publike etj.).
- Të jemi lider në punën kërkimore shkencore në fushat, siç janë: Ekonomia e ushqimit, Menaxhimi i fermave, Prodhimi bimor dhe përpunimi i produkteve bujqësore, Monitorimi mjedisor, Ekspertizat dendrologjike dhe dendrometrike të drurëve pyjorë, Ndërhyrjet silvikulturore, rivitalizimi i sipërfaqeve të degraduara të pyllit, mbrojtja e pyjeve nga zjarret etj.
- Të organizojmë një konferencë me karakter ndërkombëtar mbi resurset bujqësore dhe mjedisore,
- Të binjakëzohemi me institucionet simotra dhe të krijojmë mobilitet ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik etj.

1.3. Vlerat

Vlerat mbi të cilat është hartuar Plani Strategjik 2020-2024 udhëhiqet në drejtim të përmbushjes së misionit dhe vizionit të saj. FSHJM promovon vlerat universale, individuale dhe grupore:

- **Liria akademike:** Ne ushqejmë dhe mbrojmë hulumtimet e pavarura dhe studiuesit e përgjegjshëm. Po ashtu, vlerësojmë shkëmbimin e lirë të ideve, si dhe kolegialitetin dhe respektin e ndërsjellë për aftësitë, interesat dhe perspektivat e njëri-tjetrit.
- **Cilësia dhe Përsosmëria:** Përmes studentëve tanë, fakultetit, stafit dhe zyrës së alumnit, ne përpiqemi për përsosmëri dhe edukojmë studentët në standardet më të larta. Ne vlerësojmë cilësinë dhe përsosmërinë në veprimtaritë mësimore, kërkimore dhe shtrirëse.
- **Integriteti:** Ne e vlerësojmë integritetin dhe ndershmërinë në gjithçka që bëjmë.
- **Inovacioni:** Ne vlerësojmë ndjekjen dhe shpërndarjen e hulumtimeve dhe zbulimeve kreative.
- **Bashkëpunimi:** Ne vlerësojmë një mjedis që nxit punën në ekip dhe bashkëpunimin midis kolegëve.
- **Diversiteti:** Ne vlerësojmë shumëllojshmërinë dhe përpiqemi të integrojmë kultura të ndryshme, etnike, gjinore, socio-ekonomike dhe pikëpamje në kulturën e njësisë sonë akademike.
- **Efektiviteti:** Ne vlerësojmë administrimin aktiv dhe zhvillimin e burimeve të Fakultetit.
- **Zhvillimi akademik:** Ne vlerësojmë mundësitë për rritjen personale dhe zhvillimin e udhëheqjes.

1.4. Palët e interesit

FSHJM e planifikon zhvillimin e saj strategjik për periudhën 2020-2024 duke u mbështetur në bashkëpunimin dhe ndërveprimin e ngushtë me palët e interesit të cilat janë aktive brenda dhe jashtë mjedisit të FSHJM-së.

STAFI AKADEMIK

Stafi akademik përbën bartësit kryesorë të procesit edukativ dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore. Ky grup i interesit përfaqësohet nga profesorët e rregullt, profesorët e angazhuar, asistentët dhe bashkëpunëtorët shkencorë. Stafi akademik i rregullt kategorizohet sipas thirrjes akademike në Prof. Asoc. Dr., Prof. Ass. Dr. dhe Ass.

STAFI ADMINISTRATIV DHE TEKNIK

Stafi administrativ dhe teknik përbën palët e brendshme të interesit të cilët kryejnë funksionet operative dhe teknike të FSHJM.

- Sekretari
- Zyrtarët për shërbime studentore (Baçelor dhe Master)
- Bibliotekari
- Personeli teknik

MENAXHMENTI I FSHJM

Menaxhmenti i FSHJM-së përbën organet udhëheqëse që përkujdeset për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës edukative-kërkimore.

- Dekani
- Prodekani
- Këshilli i Fakultetit
- Këshilli i Cilësisë

STUDENTËT

Studentët janë përfituesit më të mëdhenj të procesit të krijimit dhe transferimit të dijes. Këtë grup të interesit e përbëjnë studentët kosovar dhe ata ndërkombëtarë, përfshirë këtu studentët e rregullt dhe studentët në marrëdhënie pune.

ALUMNI (STUDENTËT E DIPLOMUAR)

Alumni janë studentët e diplomuar të cilët vazhdojnë të gëzojnë shërbimet e FSHJM si dhe të kontribuojnë në lidhjen e urave të komunikimit të FSHJM me komunitetin e jashtëm. Ky grup i interesit mund të krijojë komunitetin e vet pas përfundimit të studimeve.

KOMUNITETI I BIZNESIT

Komuniteti i biznesit është palë strategjike e interesit e cila përbëhet nga përfaqësuesit e industrisë dhe bizneset lokale dhe ndërkombëtare. FSHJM bashkëpunon ngushtë me komunitetin e biznesit nëpërmjet Bordit Këshillëdhënës Industrial (KBI).

AUTORITETI QEVERITAR LOKAL DHE QENDROR


Autoriteti qeveritar në nivel lokal dhe qendror përbën një aktor të rëndësishëm në zbatimin e planit strategjik. Në këtë kuadër përfshihen përfaqësuesit e Kuvendeve Komunale të rajonit të Prizrenit, MASHT, Ministria e Financave etj.

KOMUNITETI I JASHTËM AKADEMIK DHE SHKENCOR


Komuniteti i jashtëm akademik dhe shkencor përbëhet nga partnerët e jashtëm strategjik, duke përfshirë këtu Shkollat e Mesme, Fakultetet simotra brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, Institutet kërkimore-shkencore etj.

Statistika të përmblledhura

Numri i studentëve aktivë (FSHJM)




Struktura gjinore e studentëve në të dy drejtimet - 2019/2020




Statistika të përmblledhura

Prejardhja e studentëve sipas qyteteve (2019/2020)




Personeli akademik i rregullt (2019)




Statistika të përmblodhura

Stafi mbështetës administrativ dhe teknik (2019)



Numri i punimeve shkencore të stafit akademik



2. PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

FSHJM ka për qëllim **ngritjen e cilësisë**, nëpërmjet promovimit të sinergjisë midis procesit të edukimit dhe punës kërkimore-shkencore bazuar në përvojat e mira Evropiane.

Në këtë drejtim, ky Plan strategjik mëton të **identifikojë prioritetet dhe objektivat strategjike të zhvillimit të fakultetit** në periudhën afatmesme 2020-2024.

Për shkak të faktit se FSHJM është një njësi akademike relativisht e re, Plani Strategjik 2020-2024 paraqet një plan i ri i cili mëton **identifikimin e prioriteteve strategjike** të FSHJM-së, në përputhje me kontekstin e nevojave dhe kërkesave akademike, sociale dhe ato të tregut të punës.


Në këtë Plan Strategjik **identifikohen prioritetet dhe objektivat strategjike** në kuadër të secilit prioritet strategjik.

Njëkohësisht, ky Plan Strategjik përfshin edhe **Planin e veprimit** në kuadër të të cilit planifikohen aktivitetet, masat, afatet kohore të zbatimit, bartësit dhe kostot e financimit.

Në kuadër të Planit Strategjik 2020-2024, FSHJM ka identifikuar **6 prioritete strategjike** që inkorporojnë në vete: sigurimin e cilësisë në procesin edukativ, zhvillimin e punës kërkimore-shkencore, ndërveprimin me komunitetin e biznesit, thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, përmirësimin e infrastrukturës dhe digjitalizimin si dhe ndërtimin e kapaciteteve për qëndrueshmëri financiare.

REZULTATET E PRITURA

Planit Strategjik 2020-2024 i FSHJM ka identifikuar këto objektiva strategjike:



Fuqitë

- Programe studimore unike, cilësore dhe atraktive
- Staf i ri akademik me përvojë profesionale ndërkombëtare
- Rrjet i zhvilluar i kontakteve ndërkombëtare
- Fokusim në zhvillimin e shkathtësive të studentëve
- Qasje bashkëpunuese me komunitetin e biznesit
- Shërbime administrative efikase dhe cilësore
- Shkallë e lartë bashkëpunimit e stafit
- Përgjegjësi sociale dhe transparencë në punë
- Ndërtesa funksionale për realizimin e punës edukative

- Kërkesa e lartë e tregut për studentët e diplomuar
- Shkalla e lartë e punësimit të të diplomuarve.
- Shkathtësitë e të diplomuarve për themelimin e start-up
- Interesi i shtuar i maturantëve për programet e FSHJM
- Bashkëpunimi intensiv me institutet kërkimore-shkencore
- Ngritja e kapaciteteve të institutit të FSHJM

Mundësitë

Dobësitë

- Numër relativisht i vogël i stafit të rregullt akademik
- Studentët me performance mesatare nga shkolla e mesme
- Shkalla e ulët e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve
- Përkrahja e kufizuar financiare për punë hulumtuese
- Rritja e nivelit të vetëkënaqësisë
- Numri i kufizuar i femrave në stafin akademik

- Konkurrenca e ashpër me universitetet private
- Shkalla e lartë e emigrimit të të rinjve (studentëve)
- Kufizimet e qasjes në projekte hulumtuese evropiane
- Akreditimi institucional i universitetit
- Kufizimi i qasjes në tregjet ndërkombëtare
- Shkalla relativisht e ulët e punësimit të të rinjve
- Teknologjia relativisht e vjetruar
- Varësia e theksuar nga fondet qeveritare
- Rritja e nivelit të vetëkënaqësisë

Rreziqet

3. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Plani strategjik i FSHJM ndërtohet në kornizën e 6 (gjashtë) objektivave strategjike:

- Sigurimi i cilësisë në procesin edukativ;
- Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore;
- Ndërveprimi me komunitetin dhe kontributi i FSHJM;
- Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe digjitalizimi; dhe
- Ndërtimi i kapaciteteve për qëndrueshmëri financiare.

Këto prioritetë strategjike zërthehen në objektiva me interes strategjik për FSHJM.

3.1. Sigurimi i cilësisë në procesin edukativ

Në kuadër të këtij objekti strategjik FSHJM ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 1.1:** Vlerësimi dhe kontrolli i cilësisë në procesin e edukimit përmes proceseve dhe procedurave të parapara me rregulloren e Universitetit “Ukshin Hoti” për sigurimin e cilësisë;
- **Rezultati i pritur 1.2:** Zbatimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies përmes të cilave synohet zbatimi i metodave më bashkëkohore të mësimdhënies;
- **Rezultati i pritur 1.3:** Organizimi i vizitave dhe studimore në terren dhe ndërmarrjet publike dhe private në funksion të përmbushjes së planprogramit mësimor;

- **Rezultati i pritur 1.4:** Hapja e programeve të studimit: Shkencat e Ushqimit dhe Nutricion dhe Arkitekturë peizazhi në nivelin e studimeve baçelor dhe dy programeve studimore të nivelit master: Menaxhim në agrobiznes dhe Menaxhimi i integruar i pyjeve dhe mjedisit;
- **Rezultati i pritur 1.5:** sipas kërkesave dhe prioritetëve të tregut të punës do të hapet edhe një program i studimit në gjuhën angleze me qëllim të nxitjes së mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve si dhe avancimit të procesit të ndërkombëtarizimit;
- **Rezultati i pritur 1.6:** Rekrutimi i stafit të ri akademik dhe administrativ sipas nevojave të programeve studimore, në përputhje me planifikimin e zgjerimit të portofolios së programeve studimore, përfshirë këtu edhe rekrutimin e asistentit administrativ dhe përgjegjësit të bibliotekës.

3.2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore

Në kuadër të këtij objekti strategjik FSHJM ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 2.1:** Themelimi i institutit të Shkencave të Jetës në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin akademik dhe profesional brenda dhe jashtë Universitetit;
- **Rezultati i pritur 2.2:** Përkrahja e punës kërkimore-shkencore në fushat e agrobiznesit, prodhimit bimor dhe shtazor, menaxhimit dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe ushqimit, dendrologji, shfrytëzim dhe ripyllëzim i pyjeve, mbrojtje dhe monitorim i mjedisit;

- **Rezultati i pritur 2.3:** Zhvillimi i përbashkët i projekteve kërkimore-shkencore: projektet e përbashkëta, punimet shkencore, monografitë etj., që ndihmojnë në rritjen e produktivitetit të punës shkencore-kërkimore;
- **Rezultati i pritur 2.4:** Rekrutimi i bashkëpunëtorëve shkencorë dhe stafit teknik për përmbushjen e objektivave Institutit të Shkencave të Jetës, si dhe funksionimin e punës në laboratorë.

3.3. Ndërveprimi me komunitetin dhe kontributi i FSHJM

Në kuadër të këtij objekti strategjik FSHJM ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 3.1:** Pjesëmarrje aktive në forumet e bizneseve në Kosovë, përmes të cilave synohet të adresohen problemet dhe shkëmbehen përvojat;
- **Rezultati i pritur 3.2:** Ofrimi i këshillave profesionale për palët e interesit përmes të cilës synohet që FSHJM të shndërrohet në një qendër të këshillimit për bizneset, qendrat e monitorimit dhe organet relevante qeveritare;
- **Rezultati i pritur 3.3:** Organizmi i konferencave tematike shkencore dhe panairove të karrierës përmes të cilave synohet të arrihet partneritet afatgjatë i komunitetit me FSHJM;
- **Rezultati i pritur 3.4:** Organizimi i takimeve të përbashkëta me komunitetin e biznesit përmes të cilave synohet identifikimi me nevojat e tregut të punës dhe mundësitë për

evoluimin e programeve studimore si dhe hartimin e programeve të reja.

3.4. Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Në kuadër të këtij objekti strategjik FSHJM ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 4.1:** Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me njësitë akademike ndërkombëtare simotra përmes të cilave synohet adoptimi i përvojave prestigjioze ndërkombëtare;
- **Rezultati i pritur 4.2:** Mobiliteti dhe shkëmbimi i stafit akademik me njësitë akademike ndërkombëtare simotra me përvojë në sistemin e Bolonjës;
- **Rezultati i pritur 4.3:** Mobiliteti dhe shkëmbimi i studentëve të FSHJM-së me njësitë akademike ndërkombëtare simotra, me përvojë në sistemin e Bolonjës;

3.5. Përmirësimi i infrastrukturës dhe digjitalizimi

Në kuadër të këtij objekti strategjik FSHJM ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 5.1:** Zhvillimi i infrastrukturës ekzistuese, duke përfshirë pajisjen e kabinetit të informatikës me kompjuterë dhe pajisje tjera përcjellëse të IT dhe softuer. Planifikohet investimi në pajisje shtesë në laboratorin e tokave dhe Mikrobiologjisë dhe Monitorimit mjedisor;
- **Rezultati i pritur 5.2:** Pajisja e Labororit të Mikrobiologjisë dhe Monitorimit mjedisor me inventar dhe

aparatura tjera përcjellëse të cilat ju shërbejnë studentëve dhe stafit akademik për punën praktike si dhe për punën e përbashkët shkencore-kërkimore;

- **Rezultati i pritur 5.3** Ndërtimi i laboratorit të Sistemit të Informimit gjeografik (GIS) me mundësi qasjeje për 30 studentë
- **Rezultati i pritur 5.4:** Furnizimi i vazhdueshëm me material shpenzues për mbajtjen e ushtrimeve me studentë dhe punën kërkimore-shkencore;
- **Rezultati i pritur 5.5:** Zgjerimi i hapësirave për studim dhe të bibliotekës së FSHJM: ndërtimi i së paku një salle të mësimimit me kapacitet prej 50 ulëseve dhe me sipërfaqe 75 m². Pajisja me inventar dhe furnizimi me fond të librave për bibliotekën e FSHJM-së në funksion të përmbushjes së nevojave të studentëve për hapësira të leximit dhe të hulumtimit të literaturës. Theks i veçantë do t'i kushtohet funksionalizimit të plotë në burimet elektronike (digjitale) të literaturës dhe punimeve shkencore;
- **Rezultati i pritur 5.6:** Funksionalizimi i plotë i qasjes në internet (Wi-Fi) në gjithë hapësirën e FSHJM-së dhe qasja e lirë në internet për secilin student.

3.6. Ndërtimi i kapaciteteve për qëndrueshmëri financiare

Në kuadër të këtij objekti strategjik FSHJM ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 6.1:** Gjenerimi i të ardhurave financiare vetanake nëpërmjet kryerjes së analizave gjenetike dhe pedologjike, ekspertizave profesionale etj.;

- **Rezultati i pritur 6.2:** Gjenerimi i burimeve të financimit për përmbushjen e objektivave strategjike nëpërmjet fondeve të projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore me partnerët strategjikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
- **Rezultati i pritur 6.3:** Përfitimi i projekteve kërkimore-shkencore nëpërmjet fondeve të BE-së dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare, me ç'rast planifikohet hartimi i projekteve të ndryshme shkencore dhe dhënia e këshillave apo ofrimi i trajnimeve për bizneset e ndryshme dhe organizatat publike dhe private.

PLANI I VEPRIMIT

Nr.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Masat	Bartësit	Afati kohorë	Kostoja (Euro)
Objektivi strategjik 1: Sigurimi i cilësisë në procesin edukativ						
1.	Vlerësimi dhe kontrolli i cilësisë në procesin e edukimit	Realizimi i anketave me studentë, monitorimi i mësimdhënies.	<ul style="list-style-type: none"> Vendosja e standardeve për formën dhe mënyrën e anketimit dhe përpilimi i raporteve me rezultate; Monitorimi i mbarëvajtjes së mësimit disa herë brenda semestrit. 	<ul style="list-style-type: none"> Dekani, prodekani dhe stafi administrativ. Komisioni për sigurimin e cilësisë brenda FSHJM-së 	2020-2024	0,000
2.	Zbatimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies	Trajnimi i stafit akademik në teknikat e reja të mësimdhënies.	<ul style="list-style-type: none"> Aplikimi për projekte të avancimit të vazhdueshëm profesional në karrierë 	Këshilli i FSHJM, Senati dhe aktorët e jashtëm	2020-2024	0,000
3.	Vizitat studimore në terren	Organizimi i vizitave studimore tematike në përputhje me planprogramet e lëndëve studimore.	<ul style="list-style-type: none"> Hartimi i planit të detajuar të aktiviteteve. Sigurimi i transportit, akomodimi, shujtat dhe kostot e tjera. 	FSHJM, Rektori dhe aktorët e jashtëm	2020-2024	2,000
4.	Hapja e programeve të reja studimore	Hapja e programeve studimore: <ul style="list-style-type: none"> Bachelor: Shkencat e Ushqimit dhe Nutricioni dhe Arkitekturë peizazhi Master: Menaxhim në agrobiznes dhe 	<ul style="list-style-type: none"> Hartimi i RVV dhe aplikimi për akreditim në AKA 	Stafi akademik i FSHJM dhe bartësit e programeve, Senati, Këshilli Drejtues i Universitetit	2020-2024	0,000

		Menaxhimi i integruar i pyjeve dhe mjedisit				
5.	Hapja e të paktën një programi në gjuhën Angleze	Profili i programit përcaktohet pas studimit të arsyeshmërisë.	Hartimi i RVV dhe aplikimi për akreditim në AKA	Stafi akademik i FSHJM dhe bartësit e programeve, Senati, Këshilli Drejtues i Universitetit	2020-2024	100, 000
6.	Punësimi i stafit të ri akademik	Rekrutimi i stafit të ri akademik në përputhje me kërkesat e programeve të reja	<ul style="list-style-type: none"> Hapja e konkursit për rekrutimin e tetë (8) profesorëve, katër (4) asistentëve. Një laborant – bashkëpunëtor shkencor / teknik dhe Një asistent administrativ. 	Këshilli i Fakultetit, Senati, Sekretari i Përgjithshëm dhe Rektori	2020-2024	150,000
Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore						
1.	Themelimi i Institutit të Shkencave të Jetës	Pajisja e mëtejme e Laboratorëve me aparaturat e parapara si dhe trajnimi i stafit për përdorimin e tyre. Rekrutimi i tre bashkëpunëtorëve shkencorë	<ul style="list-style-type: none"> Akreditimi i laboratorëve nga Ministria e MBPZHR dhe MSH dhe licencimi i tyre. Trajnimi i stafit dhe licencimi për punën në laborator 	FSHJM, Universiteti "Ukshin Hoti"	2020-2024	150,000
2.	Përkrahja e punës kërkimore-shkencore	Krijimi i grupeve shkencore për fushat që u përgjigjen programeve studimore	<ul style="list-style-type: none"> Përkrahja financiare për organizimin e aktiviteteve shkencore-hulumtuese të organizuara nga stafi akademik apo studentët. 	FSHJM, Universiteti "Ukshin Hoti"	2020-2024	0,000

3.	Zhvillimi i përbashkët i projekteve kërkimore-shkencore	Zbatimi i projekteve të përbashkëta me institucionet ndërkombëtare	<ul style="list-style-type: none"> Krijimi i mundësive për të mbajtur ligjërata ose praktika të drejtuara nga Institucionet ndërkombëtare partnere me FSHJM-në 	FSHJM, Organizatat ndërkombëtare, Universiteti "Ukshin Hoti"	2020-2024	0,000
4.	Përbushja e nevojave për bashkëpunëtorë shkencorë dhe staf teknik	Rekrutim i stafit të ri	<ul style="list-style-type: none"> Hapja e konkursit për një bashkëpunëtor shkencor që do të kryejë punën e laborantit dhe do të mirëmbajë laboratorët. Hapja e konkursit për një asistente administrative. 	Këshilli i Fakultetit, Senati dhe Sekretari i Përgjithshëm	2020-2024	15,000

Objektivi strategjik 3: Ndërveprimi me komunitetin dhe kontributi i FSHJM

1.	Pjesëmarrje aktive në forumet e bizneseve në Kosovë	Mbajtja e trajnimeve dhe shërbimeve tjera profesionale	<ul style="list-style-type: none"> Trajnimi i bizneseve për punëtorët Shërbime për prodhimet bimore dhe shtazore, marketing, mbrojtje bimësh dhe mjedisi, etj.. 	FSHJM	2020-2024	0,000
2.	Ofrimi i këshillave profesionale për palët e interesit	Ofrimi i aktiviteteve profesionale dhe shkencore-hulumtuese	<ul style="list-style-type: none"> Dhënia e informacioneve, këshillave, rekomandimeve që rrjedhin nga hulumtimet shkencore 	FSHJM	2020-2024	0,000

3.	Organizmi i konferencave shkencore, panairëve të biznesit	Mbajtja e konferencave shkencore në lëmin e agrobiznesit dhe Shkencave pyjore dhe Mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i punimeve shkencore në lëmin e Marketingut të agrobiznesit • Prezantimi i punimeve shkencore në fushën e Pylltarisë dhe ekotoksikologjisë 	FSHJM	2020-2024	0,000
4.	Hulumtimi i tregut të punës, gjegjësisht kërkimi i fushave inovative	Hapja e zyrës së projekteve	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i projekteve për bizneset me qëllim shtimin e të ardhurave shtesë. • Shërbimet për komunitetin, organet qeverisëse të vendit, OJQ-të dhe Organizatat donatore të tjera. 	FSHJM, BKI	2020-2024	0,000
Objektivi strategjik 4: Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar						
1.	Memorandumet e bashkëpunimit me Universitetet e shteteve ndërkombëtare	Shfrytëzimi i partneriteteve aktuale me Universitetet ndërkombëtare dhe përpjekja për krijimin e partneriteteve të reja	<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i mësimdhënies nga stafi akademik i Universiteteve partnere të BE-së. • Shkëmbimi i përvojave të ndërsjella në inovacion. • Ofrimi i bashkëpunimit me Universitetet ndërkombëtare në fushat e interesit të përbashkët. 	FSHJM, Universiteti	2020-2024	0,000

2.	Shkëmbimi i stafit akademik me universitetet ndërkombëtare	Mobiliteti i stafit akademik	<ul style="list-style-type: none"> Organizimeve i mësimdhënies nga stafi akademik i Universiteteve partnere Shqyrtimi i mundësive për mbajtjen e ligjëratave nga stafi akademik i FSHJM-së në Universitetet gjegjëse. 	FSHJM	2020-2024	0,000
3.	Shkëmbimi i studentëve të FSHJM me universitetet ndërkombëtare	Mobiliteti i studentëve	<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i ligjëratave dhe ushtrimeve, si dhe praktikës profesionale dhe asaj në terren për studentët e huaj. Shfrytëzimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për ndjekjen e kurseve apo edhe studimeve të studentëve tanë në universitetet ndërkombëtare 	FSHJM	2020-2024	0,000
Objektivi strategjik 5: Përmirësimi i infrastrukturës dhe digjitalizimi						
1.	Zhvillimi i infrastrukturës ekzistuese	Furnizimi i objektit të FSHJM me salla mësimi dhe pajisje laboratorike, kompjuterë, serrë eksperimentale, etj.	<ul style="list-style-type: none"> Furnizimi i sallës së informatikës me kompjuterë dhe softuerë Pajisja e laboratorit të tokave dhe laboratorit qendror me aparaturat të cilat mungojnë 	FSHJM, Universiteti "Ukshin Hoti"	2020-2024	82,000

			<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i serrës eksperimentale në oborrin e FSHJM • Pasurimi i sallës së herbarit me specie të reja bimore • Pasurimi (mbjellja) e kopshtit botanik me specie bimore (drunj dhe shkurre) • Pajisja e korridoreve të FSHJM me dollapë ekspozuese për speciet bimore dhe shtazore 			
2.	Pajisje a Labororit të Mikrobiologjisë dhe Monitorimit mjedisor me inventar dhe aparatura tjera përcjellëse	Zhvillimi i procedurave të prokurimit për furnizimin e aparaturat dhe inventarin për laboratorin gjegjës.	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i listës me pajisjet gjegjëse dhe inventarin për laboratorin e Mikrobiologjisë dhe Monitorimit mjedisor • Kërkesa për miratimin e pajisjes me aparaturat gjegjëse. 	FSHJM, Universiteti "Ukshin Hoti"	2020 - 2023	100,000
3.	Ndërtimi i labororit të Sistemit të informimit gjeografik (GIS) me mundësi qasjeje për 30 studentë	Zhvillimi i kërkesave dhe procedurave të prokurimit për furnizimin me aparaturat materialin gjegjës.	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i listës me pajisjet gjegjëse dhe inventarin për laboratorin e GIS 	FSHJM, Universiteti "Ukshin Hoti"	2020 - 2023	20,000
4.	Furnizimi me material shpenzues	Zhvillimi i procedurave për furnizimin e vazhdueshëm me material shpenzues	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesa për pajisje me material shpenzues (kemikale, enë laboratorike, letër herbari, fidanë të 	FSHJM, Universiteti "Ukshin Hoti"	2020-2024	15,000

			bimëve të ndryshme, si: barishte, shkurre dhe drunj; vegla pune, etj.) për qëllim mbajtjen e ushtrimeve me studentë dhe për punën shkencore-hulumtuese të stafit akademik të FSHJM-së			
5.	Zgjerimi i hapësirave për studim dhe të bibliotekës së FSHJM	Krijimi i sallës së bibliotekës së FSHJM	<ul style="list-style-type: none"> Furnizimi i sallës së bibliotekës me literaturë Fuqizimi i sistemit online në literaturë 	FSHJM, Universiteti "Ukshin Hoti"	2020-2024	0,000
6.	Funksionalizimi i plotë i qasjes në internet (nëpërmjet WI-Fi) në të gjithë hapësirën e FSHJM	Modernizimi i infrastrukturës teknologjike	<ul style="list-style-type: none"> Digjitalizimi i objektivit të FSHJM me rrjet dhe aparatura tjera përcjellëse 	FSHJM, Universiteti "Ukshin Hoti"	2020-2024	5,000
7.	Hapja e programit Shkencat e Ushqimit dhe Nutricioni dhe Arkitekturë e peizazhit në nivelin e studimeve baçelor dhe dy programe studimore të nivelit master: Menaxhim në agrobiznes dhe Menaxhimi i integruar i pyjeve dhe mjedisit	Rekrutimi i stafit akademik	<ul style="list-style-type: none"> Shpallja e konkursit për rekrutimin e stafit akademik (8 profesorë dhe 4 asistentë). 	Këshilli i Fakultetit, Senati dhe Rektori	2020-2024	150,000 (e cekur te pika 1.6)
Objektivi strategjik 6: Ndërtimi i kapaciteteve për qëndrueshmëri financiare						
1.	Gjenerimi i të ardhurave financiare vetanake	<p>Aktivizimi i laboratorit qendror dhe pajisja e laboratorëve të tjerë me pajisje shtesë.</p> <p>Rekrutimi i tre hulumtuesve shkencorë</p>	<ul style="list-style-type: none"> Vendosja e oxhakut dhe rregullimi i rrjetit të ujit në laboratorin qendror të FSHJM Përdorimi i PCR për analizë gjenetike (bimore, shtazore, humane dhe të mikroorganizmave) 	Këshilli i Fakultetit, Senati, Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti"	2020-2024	0,000

			<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i ICP dhe aparaturave të tjera për analizat pedologjike (analiza kimike te dheut). • Përdorimi i laboratorit qendror për analiza ekotoksikologjike (mjedisore, bimore, shtazore dhe humane) dhe ushqimore • Konkurs për pranimin e tre hulumtuesve shkencorë 			
2.	Përfitimimi i projekteve kërkimore-shkencore nëpërmjet fondeve të përkrahura nga BE, institucionet ndërkombëtare etj.	Rritja e të ardhurave përmes projekteve kërkimore-shkencore	<ul style="list-style-type: none"> • Aplikimi dhe ofrimi i programeve edukative në vazhdimësi për konsulencë dhe shërbime • Rritja e kontributit financiar nga studentët 	FSHJM	2020-2024	0,000